



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 12.

Prishtinë, më 06.03.2015 në orën 13:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-2.

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Valdete Bajrami, Xhavit Haliti, Rustem Mustafa, Arben Gashi, Ilir Deda dhe Blerim Shala.

Munguan: Luljeta Veselaj – Gutaj, Slobodan Petroviq, Vjosa Osmani dhe Kujtim Paçaku.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Ahter Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.02.2015;**
- 3. Takim me Shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovë, z. Samuel Zhubogor;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryetarja pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me një ndryshim, pika e tretë takimi me Samuel Zhubogor mbetet si pikë e fundit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16.02.2015.

Procesverbali u miratua në komision pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja: Tha se ky projektligj është votuar në seancë me 74 vota pro dhe me 12 kundër, dhe më pastaj, gjithashtu është analizuar në Komisionin FunkSIONAL dhe më pas edhe në tri komisionet e tjera të përhershme (Komisioni për buxhet, interesa të komuniteteve dhe legjislacion). Derisa Komisioni FunkSIONAL nuk ka ndonjë amendament, me përjashtim të një amendamenti të një deputeti z. Zafir Berisha i cili është pa përkrahjen e këtij Komisioni. Kurse, Komisioni ynë ka për detyrë që ta shqyrtojë projektligjin dhe amendamentet nga aspekti i harmonizimit ose përafrimit me legjislacionin e BE-së. Pas analizimit të këtij Projektligjit konstatohet se fusha të cilën e mbulon ky projektligj nuk është e rregulluar me legjislacionin e BE-së, por është kompetencë e shteteve anëtare që këtë fushë ta rregullojnë me legjislacionin e tyre të brendshëm kombëtar. Prandaj mund të konstatojmë se ky projektligj, si dhe amendamenti si i tillë nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja hapi diskutimin për këtë projektligj.

Ilir Deda- Tha se për informim të këtij Komisioni Lëvizja Vetëvendosje ka propozuar 8 (tetë) amendamente lidhur me këtë projektligj dhe do të diskutohet me Komisionin për siguri nëse do të procedohen për seancë plenare në lexim të dytë. Pasi që në Bashkimin Evropian nuk ka rregulla që mbulojnë këtë fushë në mënyrë specifike, është mirë që të merren praktika më të mirë të shteteve anëtare të BE-së lidhur me ndalimin në bashkimin e qytetarëve në luftëra të armatosura në organizata terroriste dhe grupe të ndryshme terroriste. Pra, përmes këtij ligji, duhet të definohet qartë ndalimi i bashkimit në luftëra të armatosura në organizatat të cilat do të shpallen terroriste, pra në këtë rast ato organizata të cilat BE-ja do t'i shpallë si organizata terroriste.

Kryetarja lidhur me informimin e z. Deda tha se këto amendamente nuk janë pranuar në këtë Komision dhe prandaj nuk mund të diskutohet rreth tyre.

Arben Gashi- U shpreh se sipas Rregullores së punës së Kuvendit këto amendamente, të cilat u potencuan duhet të dorëzohen në Komisionin FunkSIONAL dhe pastaj ky komision i procedon për shqyrtim në katër komisionet kryesore. Ato amendamente është dashur të vinë në këtë Komision pa marrë parasysh se kjo fushë nuk rregullohet me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja- Tha se pas shqyrtimit ky projektligj do të dalë në seancë plenare për miratim dhe gjithashtu konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë:

Përfundim

Projektligji nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është kundërshtim me Acquis të BE-së.

4. Takim me Shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Përfaqësuesin Special të BE-së në Kosovë, z. Samuel Zhbogar.

Kryetarja- Shprehi mirëseardhje dhe falënderoj për pranimin e ftesës z. Zhbogar, gjithashtu falënderoj institucionin që ai drejton për të bashkëbiseduar lidhur me procesin në të cilin po

kalon Kosova në rrugën e saj drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Po ashtu falënderoi institucionet e BE-së për mbështetje të vazhdueshme për Kosovën në rrugën e saj drejt integritimeve evropiane. Në Kosovë është fakt se ekziston një konsensus i plotë politik dhe një gatishmëri për rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian, që për dallim nga disa shtete në rajon ku procesi evropian është më i përparuar se sa në Kosovë, dhe pse nuk ekziston një konsensus politik çfarë ekziston në Kosovë.

Pyeti përfaqësuesin e BE-së për procesin dhe për nënshkruhet e Marrëveshjes për Stabilizim Asociim, pasi që dihet se negociatat kanë përfunduar me vënien e inicialeve të para. Po ashtu, procesin e liberalizimit të vizave, duke e njoftuar se në këtë Komisioni kanë raportuar ministri për Integritime Evropiane dhe ministri i Punëve të Brendshme. Ku më atë rast është diskutuar për procesin e liberalizimit të vizave dhe përmbushjen e kriterëve (teknike), si dhe diskutimeve për migrimin e parregullt i cili nuk ka pasur ndikim të mirë në Bashkimin Evropian. Kosova duhet të trajtohet njësoj sikurse dhe vendet e tjera përfituese të procesit të liberalizimit të vizave duke pasur parasysh faktin se Kosova është vendi i vetëm i cili në këtë pjesë të Evropës nuk mund të udhëtojë ende pa viza në Bashkimin Evropian. Nga ana tjetër, duhet të bëhet e ditur nga BE-ja se cilat janë mendimet për përmbushjen e kriterëve, edhe pse Ministria e Punëve të Brendshme ka deklaruar se deri në fillim të verës së këtij viti do të përmbushen të gjitha kriteret. Gjithashtu, pyetja tjetër lidhur me zbatimin e Marrëveshjes së 24 shkurtit 2012, ku konkretisht në pikat 8 dhe 9, kërkon që Kosova të jetë pjesë e organizmave ose strukturave regjionale si anëtare e barabartë. Fakti që kanë kaluar tri vjet të kësaj marrëveshje, Kosova ende vazhdon të jetë pjesëmarrëse vetëm si vëzhguese të këtyre organizatave rajonale, shembull takimin e COSAP-it ku dhe ju jeni të njoftuar për kërkesën tonë për anëtarësim, përveç kësaj gjithashtu dhe në shumë nisma tjera rajonale. Prandaj, u kërkuar nga BE-ja që ta ndihmoj Kosovën dhe institucionet e saj të jetë pjesë e barabartë në nismat rajonale me karakter bashkëpunimit.

Samuel Zhbogar- Falënderoj kryetaren dhe anëtarët e Komisionit Parlamentar dhe tha se ndihet i nderuar që është në këtë komision shumë të rëndësishëm, si për nga fuqia dhe përbërja e tij. U potencua se sa është i rëndësishëm procesi i integritimit evropian, kështu shihet edhe në programin e punës të këtij komisioni për këtë vit, i cili është një program shumë ambicioz dhe i shumë e rëndësishme. Ftesa e ministrave për të raportuar në këtë komision dhe vizita jashtë vendi, vizitat te komisionet homologe të parlamenteve të ndryshme. Gjithashtu, vizitat e planifikuara për t'u realizuar në Bruksel. Pra, plan i punës së këtij komisioni është inkurajues dhe mirë që të realizohet në tërësi. Ky komisioni është komision kryesor dhe ligjet kryesore që kanë të bëjnë me integritimin evropian kalojnë nëpër këtë komision parlamentar. Me rëndësi është që të ketë një mekanizëm për përafrimin e legjislacionit vendor me Acquis të BE-së. Një mekanizëm i tillë është krijuar në zyrën e BE-së në Prishtinë dhe është duke kontaktuar në Bruksel në aspektin e shikimit të ligjeve e Kosovës duke i krahasuar ato me legjislacionin e Bashkimit Evropian, në mënyrë që gjatë hartimit të ligjeve të jepen pikëpamjet lidhur me përafrimin e këtyre draft-ligjeve. Ekziston një bashkëpunim i mirë me qeverinë e Kosovës dhe ky bashkëpunim duhet të rritet edhe me Kuvendin për të ndihmuar në hartimin e ligjeve me qëllim të përafrimit dhe harmonizimit me legjislacionin e BE-së.

Kurse Marrëveshja e Stabilizim Asociimit është një marrëveshje në mes Kosovës dhe BE-së e cila në momentin kur do të nënshkruhet nënkupton lidhjen e një kontrate të rëndësishme në mes të BE-së dhe Kosovës për rrugën drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Kosova është në fokus të BE-së, kjo mund të shihet edhe përmes vizitave të shpeshta që përfaqësuesit ose institucionet e BE-së bëjnë në Kosovë. Po ashtu është me rëndësi që këta zyrtarë dhe komisionarë që vizitojnë Kosovën ta vizitojnë edhe Komisionin për Integritime Evropiane. Komisionari Hahn do të vijë në Kosovë së shpejti dhe do ta vizitojnë edhe këtë komision. MSA-ja do të jetë hapi i parë drejt integritimit dhe si e tillë është duke u përkthyer në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së dhe kjo pritet që të përfundojë në muajin prill, më pastaj kjo marrëveshje duhet të aprovohet nga kolegji i Komisionit Evropian dhe do të dërgohet te shtetet anëtare të cilat duhet të aprovojnë gjithashtu. Shpresohet që nënshkrimi të ndodhë gjatë verës, megjithatë traktati pritet të hyjë në fuqi tek gjatë

vitit 2016. Kjo ngjarje pritet të ndodhë së shpejti sepse hap një bashkëpunim në nivel institucional në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian.

Kur flitet për bashkëpunimin duhet të përmendet takimi ndër-ministral të vendeve të Ballkanit Perëndimor i cili pritet të ndodhë në Prishtinë më 25 mars 2015, dhe i cili është më rëndësor për dy çështje: së pari për shkak se është takimi i gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor që do të mbahet me Komisionarin Evropian Hahn, ndoshta dhe Komisionari për transport Bulc. Takimi do të krijojë lidhje në fushën e transportit të vendet të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian. Nga ky takim pritet që të dalë një propozim që të krijohet një rrjet për bashkëpunim në mes të vendeve të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian. Pas kësaj pritet të mbahet në pranverë një samit në Vjenë që është një vazhdim i procesit të Berlinit të filluar më parë. Kjo konferencë është e rëndësishme sepse do të bisedohet për planet për një lidhje të këtyre vendeve me Bashkimin Evropian.

Gjithashtu, kjo është e rëndësishme në aspektin politik për faktin që do të mbahet në Prishtinë, ku zëvendëskryeministri Thaçi do të jetë si organizator ku do të marrin pjesë institucionet e tjera nga rajoni.

Lidhur me marrëveshjen e vitit 2012, tha se është e vërtetë se Kosova çdo ditë e më shumë po avancohet drejt anëtarësimit në organizata rajonale, ku përmendi anëtarësimin në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal dhe vitin e kaluar Kosova është ftuar që të marrë pjesë në Procesin e Bashkëpunimit të vendeve të Evropës Jug - Lindore që është mbajtur në Rumani, kurse pastaj Kosova ka marrë pjesë në takimin i cili është organizuar në Shqipëri. Një letër është pranuar ku njoftohet se parlamentarët mund të përfshihen në takimet e COSAP-it i cili do të mbahet javën e ardhshme në Beograd, e që kësaj here pjesëmarrja do të jetë si vëzhgues në këtë takim dhe në të ardhmen shpresohet se do të jetë anëtare dhe pjesë e barabartë në COSAP.

Ndërsa për procesin e liberalizimit të vizave me të cilin nuk u pajtua se vala e migrimit të parregullt ka qenë si pasojë e mos liberalizimit të vizave për Kosovën, sepse liberalizimi i vizave nënkupton që qytetarët e Kosovës të lejohen të udhëtojnë pa viza në BE vetëm për vizitë dhe jo për punësim, siç ka ndodhur rasti i migrimit kohët e fundit ku qytetarët e Kosovës kanë kërkuar azil në vendet e BE-së. Numri i emigrantëve është mirë që është ulur ditët e fundit, por shqetësim mbetet shkalla në rritje e pakënaqësisë qytetare për gjendjen në Kosovë. Programi i qeverisë është lajm i mirë dhe është mirëpritur dhe porositë ishte që ky program të shikohet nga të gjithë si pozitiv, opozitiv dhe shoqëri civile dhe të angazhohen të gjithë për realizimin e këtij programi.

Vitin e kaluar në Kosovë ka qenë një Komision vlerësues për përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave, i cili ka dhënë rekomandimet e tij, pas përmbushjes së tyre pritej që Kosova të japë përgjigjet lidhur me rekomandimet. Pas pranimit të përgjigjeve ato do të verifikohen dhe do të bëhet një vlerësim i situatës së përgjithshme në terren duke shpresuar që numri i emigrantëve të zvogëlohet në mënyrë të konsiderueshme dhe rekomandimet për liberalizim të adresohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Kuptohet se Kosova është vendi i vetëm në rajon i cili ende nuk ka përfituar nga liberalizimi i vizave dhe kuptohet se kjo nuk është një ndjenje e mirë për institucionet dhe qytetarët. Për dallim nga vendet tjera të rajonit është e ditur se procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën ka filluar më vonë dhe është më i vështirë se për vendet tjera, për arsye të përvojës jo të mirë nga vendet të cilat më parë kanë përfituar nga liberalizimi. Ky proces pritet që të përfundojë shumë shpejt dhe pas dërgimit të përgjigjeve të qeverisë dhe vlerësimit të tyre priten lajme të mira.

Kryetarja- E falënderoj Zhbogarin dhe tha se programi i Qeverisë ka kaluar në Qeveri dhe këto ditë pritet të kalojë në Kuvend, si një hap përpara për një zhvillim ekonomik. Kurse nënshkrimi i MSA-së për një qytetar nuk do të paraqet ndonjë domethënie sa do të jetë liberalizimi i vizave për shkak se për qytetarët do të jetë e prekshme. Marrja e vizave në Kosovë është bërë po ashtu një ngarkesë, jo vetëm për qytetarët, por edhe për deputetët, duke përmendur rastin që disa deputetë të Kuvendit të Kosovës për një vizitë zyrtare në Bashkimin Evropian janë pajisur me vizë vetëm për tre ditë edhe pse kanë pasur pasaportë diplomatike.

Ilir Deda- E falënderoi për prezencën e tij në Komision, tha se ky është një proces shumë i rëndësishëm sa i përket definimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Ky komision është shumë aktivë për arsye të agjendës dhe rëndësisë së procesit të Kosovës drejt integritetit në BE. Komenti i parë lidhet me zhgënjimin e madh për arritjen e marrëveshjes në Bruksel për gjyqësi, siç dihet se shërbimi civil është staf civil dhe nuk është një praktikë e tillë e Bashkimit Evropian dhe kjo marrëveshje e shkel Kushtetutën e Kosovës, shkel barazinë e qytetarëve, shkel të Konventën e të drejtave të njeriut të BE-së. Shembull është ajo çfarë është kërkuar për Bosnjën nga Bashkimi Evropian ku është lejuar që vendimet të merren nga institucionet e saj pa i shkelur të drejtat e qytetarëve të saj. Pra u cilësuar zhgënjyese arritja e kësaj marrëveshje në Bruksel. E dyta, Kosova është shteti i vetëm në rajon që procesi i liberalizimit të vizave nuk ka pas lehtësime, kurse në anën tjetër marrja e një vize ka procedura shumë burokratike, ku qytetarët e Kosovës pajisen me vizë tre ditore dhe nuk ka shpjegime pse dhënia e vizave për qytetarët është ndryshe nga vendet e rajonit. Po ashtu është e vërtetë se nuk janë bërë detyrat e shtëpisë dhe Vetëvendosje ka bërë thirrje që Kosova t'i bëjë detyrat e saj lidhur me përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave. Sa i përket MSA-së pse ne si anëtarë të parlamentit pasi që duhet të ratifikojmë këtë marrëveshje nuk kemi të drejtë ta shohim këtë marrëveshje paraprakisht? Nëse kjo marrëveshje do të arrihet, kush do ta nënshkruaj këtë marrëveshje, a do të jetë ai kryetari i shtetit apo kryeministri (pra nga ana kosovare)? Dhe së treti, falënderoj shumë nëse shpjegon Kapitullin 35. Nëse Kosova do të ketë mundësi që ta nënshkruaj kornizën ligjore për komunitet me Bashkimin Evropian për arsye se nuk ekziston një zgjidhje lidhur me këtë. Duke përfunduar falënderoj Zhbogarin për prezencën e tij në këtë takim me Komisionin.

Valdete Bajrami- E falënderoj për prezencën në Komision dhe se shumë çka u tha lidhur me liberalizimin e vizave dhe raportimin e ministrave në komision, mirëpo me rëndësi është të përmendim atë që ministri Çollaku ka potencuar në këtë komision se liberalizimi i vizave për Kosovën këtë vit nuk do të realizohet, sepse nuk janë krijuar kushtet. Pra qytetarët nuk mund të shpresojnë për udhëtim pa viza brenda këtij viti. Duke u ndërlidhur me ngjarjet e fundit të cilat kanë ndodhur në Kosovë këto ditët në Misionin e EULEX-it. Skandalet e njëpasnjëshme në Misionin EULEX, në veçanti ai i cili është bërë publik në gazetën Koha Ditore. Pyeti se cili është komenti i tij për këtë skandal ku janë të përfshirë zyrtarë të misionit të EULEX-it, por edhe të Bruksel-it. Pse deri më tani nuk ka një konfirmim ose raport nga zyra e BE-së që është këtu prezent në Kosovë lidhur me këtë rast. Ky mision është këtu për sundimin e ligjit dhe skandalet e fundit kanë ulur imazhin e tij. Dhe lidhur me këtë pyeti pse dëshmitarët të cilët kanë ofruar prova lidhur me këtë rast nuk janë marrë parasysh dhe mbrojtur nga ky mision, kur kjo çështje ka të bëjë me zbardhjen e së vërtetës. Gjyqtari Manuel Suarez i cili ka deklaruar se do ta dënojë Fatmir Limaj pa pasur as ndonjë dëshmi ose provë, një lajm që mund të gjendet në gazetën Koha Ditore. Pra, nëse një rast i tillë do të ndodhte në një vend të BE-së ose në vendin tuaj çka do të ndodhte, ku në restorante gjyqtarët do të deklarorin një gjë të atillë.

Siç dihet institucionet e BE-së vazhdimisht kanë bërë thirrje që politika të jetë larg sistemit të drejtësisë, kurse kemi një heshtje lidhur me këtë rast nga këto institucione, prandaj e luti që ky rast të merret me seriozitet dhe të trajtohet nga këto institucione sa më shpejt që të jetë e mundur.

Xhavit Haliti- Kërkoi që të ndihmohet lidhur me hartimin ose ri-hartimin e ligjit për investimet e huaja me qëllim që të lehtësohen investimet e huaja në Kosovë, që afaristet e huaj ta kenë më lehtë të investojnë në Kosovë. Kjo do të ndihmojë në zbutjen e papunësisë në Kosovë dhe ndalimin e largimit të qytetarëve të saj jashtë vendit për çështje ekonomike. Dhe e dyta pyetja se cila është pengesa më e madhe e cila i bëhet Kosovës për liberalizimin e vizave, nëse janë pengesë nga pesë vendet anëtare të BE-së të cilat ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës ose kriza ekonomike apo ndonjë arsye tjetër.

Arben Gashi- Tha se nëse Zyra e BE-së në Kosovë ka ndonjë rol lidhur me zbatimin e marrëveshjeve që janë bërë në mes të Serbisë dhe Kosovës dhe nëse është bërë ndonjë raport

lidhur me zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Pyeti gjithashtu nëse ka ndonjë afat kohor deri kur do të dialogohet me Serbinë në Bruksel?

Samuel Zhbogar- Shprehu gatishmërinë që të mbështes në çështjen e investimeve të huaja në Kosovë dhe se njoftuar se çfarë ligjesh kanë shtetet e tjera sa i përket investimeve të huaja. Gjithashtu tha se një vit më parë është krijuar Këshillin Evropian për investime të huaja në përbërje e tij 17 anëtarë nga Bashkimi Evropian janë anëtarë të këtij këshilli. U shpreh i gatshëm të punojmë me Kosovën për ngritjen e një zhvillimi ekonomik dhe investimeve të huaja direkte. Kurse për liberalizimin e vizave ka shumë arsye dhe nuk është një e vetme për pengesën e deritashme që akoma nuk ka ndodhur liberalizimi i vizave. Pesë vendet që nuk e kanë njohur ende Kosovën nuk paraqesin pengesë të bëhet procesi i liberalizimit të vizave, por situata ekonomike e cila ndodhet në Evropë sigurisht se do të ndikoj dhe gjithashtu shkak i numrit të madh të njerëzve që cilët kanë kërkuar azil në vendet e BE-së i cili ka qenë numër i madh i tyre. Patjetër që duhet t'i përmbahet procesi i liberalizimit dhe ta përmbushen kriteret në mënyrë që të bëhet liberalizimi sikurse se ka ndodhur me vendet e tjera të rajonit dhe së fundmi me Moldavinë. Migrimi i cili ka ndodhur gjithashtu është një pengës i cili ka ndikuar në këtë proces dhe nuk i ka ndihmuar Kosovës, sepse shtetet anëtare të BE-së këtë migrim e shohin ndryshe. Kosova gjithashtu nuk ka kaluar në procesin e lehtësimit të vizave dhe ne kemi kërkuar që të bëhet lehtësim për një kategori të caktuar për marrja e vizave.

Ka kaluar një kohe e gjatë që nga viti 2012 ku janë bërë shumë përparime dhe me padurim pritet raporti vlerësues për liberalizimin e vizave i cili pritet të dorëzohet gjatë pranverës. Ndërsa për MSA-së, ajo është duke u përkthyer dhe pastaj do të dërgohet që të shikohet. Institucionet e Kosovës duhet të vendosin për ndarjen e marrëveshjes në mes tyre dhe nëse duhet të merret aprovimi në Kuvend para se të nënshkruhet ose jo.

Pas nënshkrimit të MSA-së duhet që të nënshkruhet edhe marrëveshja kornizë e cila do të hapë mundësinë që Kosova të jetë pjesë e programeve, e cila do të shqyrtohet pas nënshkrimit të marrëveshjes. Nga ana e Kosovës nuk e dimë se kush do ta nënshkruajë MSA-në, kurse nga ana e BE-së znj. Mogerin do ta nënshkruaj në emër të Bashkimit Evropian dhe të shteteve anëtare të saj dhe pastaj do të dërgohet për nënshkrim në të gjitha vendet anëtare. Kapitulli 35 lidhur me dialogut me Serbinë është një kapitull shumë i rëndësishëm dhe pritet të shikohet se si Serbia është duke e zbatuar marrëveshjet e arritura me Kosovën në Bruksel. Kurse roli ynë në Kosovë është të përcjellët zbatimin e ligjeve gjatë procesit të zbatimit të marrëveshjeve dhe raportimet në Bruksel. Shembulli i disa marrëveshje si për gjyqësi ku EULEX do të ketë një rol shumë të rëndësishëm, mirëpo ka edhe marrëveshje ku ne vetëm jemi mbikëqyrës të zbatimit të tyre. Siç e dini se çdo zbatim i këtyre marrëveshjeve ku mund të ketë probleme dhe roli ynë do të jetë që të ndihmojmë të dyja palët, pra Kosovën dhe Serbinë që t'i tejkalojnë problemet që shfaqen gjatë zbatimit të marrëveshjeve. Dialogu do të vazhdojë për sa kohë që të dyja palët të jenë të gatshme që të dialogojnë së bashku deri në normalizimin e marrëdhënieve, pra nuk ka afat kohor kur do të përfundojnë negociatat. Marrëveshja për gjyqësi është shumë e rëndësishme sepse kjo është pengesa e fundit e Kosovës në rrugën e integritit të saj në BE.

Duhet të jetë e qartë se BE nuk ka agjendë të brendshme politike të preferencave dhe nuk ndërhyjmë në gjyqësor. EULEX është këtu që të ndihmoj institucionet në sundimin e ligjit në Kosovë. Bashkimi Evropian ka institucionet e veta që të verifikojnë gjërat që ndodhin në Kosovë dhe që mund të jenë të gabueshme, kjo është për sa i përket prokurores Bamje, dhe BE e ka themeluar një ekip hetuesish për supozimet për EULEX-in dhe pritet që të dalin me rezultate konkrete në fund të marsit. Kurse sa i përket shtypit ditëve të fundit nuk është parë se ka pasur prova sa i përket këtyre supozimeve dhe nuk ka asgjë konkrete ende me këtë rast. Gjyqtari Suarez është larguar nga paneli dhe një tjetër gjyqtar është ardhur në vend të tij në EULEX. Gjithashtu ka pasur dhe hetime të brendshme për të verifikuar këto supozime nëse vërtet ka ndodhur, mirëpo nuk janë gjetur dëshmi dhe dëshmitari i vetëm e ka tërhequr deklaratën e tij. Pra janë hetime rreth deklaratave të gjyqtarit Suarez për rastin e Kleçkës dhe janë duke u ndjekur ato të cilat janë thënë, por pa dëshmi konkrete. Zëdhënësi i BE-së dje ka dhënë një deklaratë që ka thënë se ky institucion nuk kanë ndërhyrë asnjëherë në çështjet e gjyqësisë në Kosovë.

Valdete Bajrami- ndërhyri duke e falënderuar për përgjigjet por në këtë rast tha se janë gjetur dëshmi në shkëmbimin e e-mailave dhe dëshmi tjera që njerëz janë të gatshëm të ofrojnë të cilët kanë kërkuar mbrojtje nga EULEX-i. Pra qartë shihen shkëmbimet e e-mailave në mes zyrtareve të EULEX dhe janë dëshmi lidhur me këtë rast.

Samuel Žbogar- Tha se nuk kanë parë se ka pasur shkëmbim të e-mailave dhe se vetëm është fol për shkëmbimin e tyre. Theksoj se BE nuk agjendë politike ose ndërhyrje në politikën e brendshme dhe nuk është politika e Bashkimit Evropian ajo për Kosovën.

Kryetarja- E falënderoj përfaqësuesin e BE-së në Kosovë i cili ka pranuar të takohet me Komisionin dhe për të biseduar për çështjet të cilat janë me interes për Kosovën dhe gatishmërinë e tij për të ndihmuar në tema të ndryshme siç është ligji për investimet e huaja, Këshillin për investime dhe gjithashtu për ligjin për parlamentin që është në raportin e progresit. Dhe tha se në të ardhmen përfaqësuesit e lartë evropian gjatë vizitave në Kosovë të takohen edhe me Komisionin për Integritet Evropian.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Teuta Sahatqija